


Legji
B.P. 2015
pp



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M



Nr. 721, datë 2.9.2015

P Ë R

NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.718,
DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN
E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES
TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- a) Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohet individi i renditur në shkronjën "a" të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për organizatën Al-Qaida.
- b) Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", regjistrohet individi i renditur në shkronjën "c" të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij

vendimi, sipas shtesës në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".


KRYEMINISTRI



EDI RAMA

MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME

DITMIR BUSHATI



**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
ORGANIZATËN AL-QAIDA**

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë
me organizatën Al-Qaida”;

1. AL SAYYID; AHMED; FATHI; HUSSEIN ELIWAH.

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
ORGANIZATËN AL-QAIDA**

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me
organizatën Al-Qaida”;

1. THE ARMY OF EMIGRANTS AND SUPPORTERS.

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilave janë radhitur më
sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të
Parave.

NR.PROT.3993
DATË 7.8. 2015

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
SHISH
BANKËS SË SHQIPËRISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëlli AGAÇI

